

Në mbështetje të nenit 5, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.1.1, nenit 12, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 dhe nenit 22, paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21, paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me nenin 29, paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-017, për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 01.03.2023, nxjerrë këtë:

V E N D I M

Mbyllet rasti me nr. AKK-DPKI-06-4517/22, për zyrtarin e lartë z. Shpejtim Dylazeka, Anëtar i Këshillit Drejtues të Universitetit “Fehmi Agani” në Gjakovë, për shkak së është shmangur gjendja e papajtueshmërisë, përkatësisht konfliktit të interesit në ushtrim të funksionit publik.

A r s y e t i m

Pas pranimit të informacionit të jashtëm nën dyshimin për konflikt të interesit në ushtrimin e funksionit publik, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (në vijim: Agjencia), ka hapur rastin me numër protokolli AKK-DPKI-06-4517/22, për zyrtarin e lartë z. Shpejtim Dylazeka, anëtar i Këshillit Drejtues të Universitetit “Fehmi Agani” në Gjakovë, duke zhvilluar procedurën e paraparë sipas Ligjit nr.06/L-01, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik (në tekstin e mëtutjeshëm: Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit).

Agjencia ka filluar trajtimin e rastit në fjalë, duke bërë fillimisht verifikimin dhe konfirmimin e këtij informacioni në institucionet përkatëse, prej nga rezulton se z. Shpejtim Dylazeka, krahas ushtrimit të funksionit si zyrtar i lartë publik, respektivisht anëtar i Këshillit Drejtues të Universitetit “Fehmi Agani” në Gjakovë, njëkohësisht është edhe Përfaqësues i Autorizuar në biznesin individual “Shpejtim Dylazeka” B.I.

Më pas, bartësi i lëndës e ka njoftuar zyrtarin e lartë z. Shpejtim Dylazeka lidhur me rastin në fjalë, duke i sqaruar se gjatë ushtrimit të funksionit publik, në cilësinë e zyrtarit të lartë publik, ai nuk mundet që njëkohësisht të jetë Përfaqësues i Autorizuar në biznes, sepse kjo situatë paraqet gjendje të papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik, siç përcaktohet me nenin 13, paragrafi 1, të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, ku thuhet se:

1. "Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksionit".

Pas diskutimit dhe ballafaqimit të fakteve, zyrtari i lartë z. Shpejtim Dylazeka është pajtuar me gjetjet e Agjencisë, duke deklaruar se do të ndërmarr veprime konkrete në mënyrë që të shmang papajtueshmërinë në ushtrimin e funksionit publik.


Ndërkohë, Agjencia ka pranuar shkresën zyrtare (DPKI-06-148/23), me të cilën dëshmohet se zyrtari i lartë z. Shpejtim Dylazeka ka bërë ndryshimet e kërkuara nga Agjencia dhe se i njëjti nuk figuron më të jetë Përfaqësues i Autorizuar në biznesin privat "Shpejtim Dylazeka" B.I.

Me veprimet e ndërmarra nga zyrtari i lartë, janë krijuar rrethana të reja me çfarë është shmangur gjendja e papajtueshmërisë, përkatësisht konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë.

Prandaj, në bazë të asaj që u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik,
- Drejtorit të DPKI-së,
- Zyrtarit përgjegjës.
-


Yll Buleshkaj
Drejtore i Agjencisë
për Parandalimin e Korrupsionit

